



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-033

Prishtinë, më 19 shtator 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 19 SHTATOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejane Selmani, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Sasha Milosavljeviq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE: Saniye Berisha.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 shtator 2011,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 shtator 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, mbajtur më 13 shtator 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të enjten, më 22 shtator 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre,

14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit,
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
16. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave.

3. Të ndryshme:

- Situata në veriun e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me situatën në veriun e Republikës së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Punëve të Brendshme, që ta përgatitë një Informatë për situatën në Veriun e Kosovës. Ministri i Punëve të Brendshme, në fillim të mbledhjes plenare më 22 shtator 2011, duhet t'i informojë deputetët e Kuvendit për situatën në Veriun e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë Informatë nuk do të zhvillohet debat.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.